



CONFERENCE OF INGOs
OF THE COUNCIL OF EUROPE

CONFERENCE DES OING DU
CONSEIL DE L'EUROPE

CONF/PLE (2009)CODE1

**KODI I PRAKTIKAVE TË DREJTA LIDHUR ME PJESËMARRJEN CIVILE
GJATË PROCESIT TË VENDIMMARRJES**

**Miratuar nga Konferenca e Organizatave Ndërkombëtare Joqeveritare
në mbledhjen e saj më 1 tetor 2009**

Tregues

I. Hyrje.....	3
II. Objektivat dhe grupet e synuara.....	5
III. Kuadri i përgjithshëm i pjesëmarrjes civile.....	6
IV. Mënyrat e pjesëmarrjes.....	8
V. Model i pjesëmarrjes civile.....	22

I. Hyrje

Një nga shqetësimet kryesore të demokracive moderne ka të bëjë me mungesën e interesimit të qytetarëve ndaj proceseve politike. Në këtë kuadër, shoqëria civile përbën një element të rëndësishëm të procesit demokratik. Ajo u jep qytetarëve një mjet alternativ, krahas mjeteve në duart e grupeve ndikuese dhe të partive politike, për të vënë në lëvizje pikëpamje të ndryshme dhe për të garantuar mbajtjen parasysh të interesave të larmishme gjatë procesit politik vendimmarrës.

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës njohu edhe një herë në tetor 2007 – nëpërmjet Rekomandimit (2007)¹⁴ – “kontributin themelor që sjellin organizatat joqeveritare (OJQ-të) në zhvillimin dhe realizimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sensibilizimit të publikut dhe pjesëmarrjes në jetën publike, duke u përkujdesur për transparencën dhe për domosdoshmërinë e dhënies llogari nga ana e autoriteteve publike”.

Gjatë mbledhjes së Forumit për të Ardhmen e Demokracisë të Këshillit të Evropës, që u zhvillua në qershor 2007 në Suedi, pjesëmarrësit ftuan Konferencën e Organizatave Joqeveritare Ndërkombëtare (OJQN) të Këshillit të Evropës të përpunojë një Kod të praktikës së drejtë për pjesëmarrjen civile gjatë procesit të vendimmarrjes, i cili të mbulojë tema të tilla si mekanizmat e pjesëmarrjes së OJQ-ve në procesin vendimmarrës dhe përfshirjen e shoqërisë civile në politikat publike.

Konferenca e OJQN-ve u nis mbi këtë bazë për të pranuar përgjegjësinë e hartimit të Kodit të drejtë për pjesëmarrjen civile gjatë procesit vendimmarrës. Ky dokument përkufizon vetë arsyen e të qenit, kuadrin dhe mjetet e forcimit të pjesëmarrjes civile. Ai u përpunua nga përfaqësuesit më me përvojë të shoqërisë civile, në kuadrin e një procesi konsultativ pan-evropian, u testua dhe u komentua nga anëtarët e organizatave joqeveritare kombëtare e ndërkombëtare dhe përdoret tashmë nga militantë e përfaqësues të pushteteve publike.

Konferenca e OJQN-ve të Këshillit të Evropës arriti të realizojë kështu një mjet të përshtatshëm, të strukturuar e pragmatik, që u vihet në duar vendimmarrësve dhe shoqërisë civile të organizuar, përfshirë edhe OJQ-të. Ajo ndihmoi në këtë mënyrë në lehtësimin e ndërveprimeve dhe të bashkëpunimit të tyre, si dhe në përforcimin e mjeteve vepruese dhe të pjesëmarrjes së tyre në procesin demokratik.

Kodi përbën një repertor praktikash të drejta për zbatim. Është pra e qartë se ai nuk ka karakter detyrues, nuk parashkruan rregulla dhe nuk kërkon mekanizma të posaçëm realizues. Ai u parashtron vijat drejtuese tërë palëve të përfshira në sistemin demokratik, frymëzuar nga përvoja konkrete e dialogut dhe e bashkëpunimit midis OJQ-ve dhe pushteteve publike. Qëllimi i fundit i tij është të lehtësojë ndërveprimet dhe bashkëpunimin e tyre dhe, nga ana tjetër, të forcojë mjetet vepruese dhe pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë procesit demokratik në rrafsh vendor, rajonal e kombëtar.

Konferenca kërkoi mendimin dhe kontributin e organeve të tjera të Këshillit të Evropës. Kongresi i pushteteve lokale dhe rajonale, si dhe Asambleja parlamentare e Këshillit të Evropës e përshëndetën Kodin e praktikave të drejta: Kongresi është kështu i gatshëm të ndihmojë në përhapjen e tij dhe ta përdorë atë gjatë punës që kryen, ndërkohë që Asambleja parlamentare vuri në dukje rëndësinë e mjeteve elektronike për nxitje të pjesëmarrjes.

Kodi mund dhe duhet të ketë efekte politike. Ai do mbështesë dhe do t'i japë hov prirjes së sotme të pushteteve lokale, rajonale dhe kombëtare për t'u këshilluar me shoqërinë civile dhe për të bashkëpunuar me të nëpërmjet mjeteve moderne të qeverisjes demokratike, duke nxitur përherë e më shumë pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike.

II. Objektivat dhe grupet e synuara

Objektivi kryesor i këtij Kodi të praktikave të drejta është të ndihmojë në krijimin e një mjedisi të favorshëm për OJQ-të në Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe në Bjellorusi, duke përcaktuar në rrafsh evropian një tërësi parimesh të përgjithshme, vijash drejtuese, mjetesh e mekanizmash për pjesëmarrjen civile në procesin vendimmarrës politik. Kodi lypset zbatuar në nivel lokal, rajonal e kombëtar. Mbështetet në përvojat konkrete të OJQ-ve të vendeve të ndryshme të Evropës, duke përputhur praktikat e drejta dhe metodat e sprovuara në nisjen e dialogut me autoritetet publike.

Kodi i praktikave të drejta propozohet po ashtu, për krejt OJQ-të, qoftë në rrafsh vendor, qoftë në rrafsh ndërkombëtar, edhe si mjet i nevojshëm e i efektshëm në dialogun e tyre me parlamentet, qeveritë dhe autoritetet publike. Ai synon të jetë ndër-aktiv e konkret, që të mund t'u shërbejë si OJQ-ve ashtu dhe pushteteve publike në vendet e ndryshme të Evropës. Për të nxitur zbatimin e tij, do të shoqërohet nga një seri studimesh sipas rastit, si dhe nga një seri mjetesh praktike.

Kodi i praktikave të drejta është i destinuar për OJQ-të kombëtare, përfshirë edhe degëzimet e tyre rajonale e lokale, të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës e të Bjellorusisë, si dhe për organizatat që veprojnë në rrafsh evropian e ndërkombëtar.

Pushtetet publike përbëjnë një pikësynim tjetër, domethënë është fjala konkretisht për parlamentet, qeveritë dhe administratat publike në nivel lokal, rajonal e kombëtar. Objektivi është sigurisht i gjerë, por është parashikuar që disa pjesë të Kodit të mund të përdoren në krejt rrafshet e administratës publike.

III. Kuadri i përgjithshëm i pjesëmarrjes civile

III.1 Parametrat e shoqërisë civile

Ndihmesa e OJQ-ve dhe e shoqërisë civile të organizuar është e domosdoshme për zhvillimin dhe realizimin e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut. Rekomandimi (2007)14 i Komitetit të Ministrave u jep OJQ-ve përkufizimin e mposhtëm: “OJQ-të janë entitete apo organizata autonome vullnetare, krijuar për të realizuar objektiva posaçërisht jofitimprurëse për themeluesit apo pjesëmarrësit e tyre”. Kodi i praktikave të drejta e përdor termin për t’iu referuar shoqërisë civile të organizuar, ku përfshihen grupet vullnetare, organizatat për qëllime jofitimprurëse, shoqatat, fondacionet, organizmat e bamirësisë, si dhe lëvizjet shoqërizuese e veprimtare të një bashkësie gjeografike apo të një grupimi interesash. Vlerat që qëndrojnë në themel të veprimtarive të OJQ-ve bazohen në drejtësinë shoqërore, në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Qëllimi i OJQ-ve është t’i shërbejnë çështjeve thelbësore që parashtrihen në këto fusha, si dhe të ndihmojnë në përmirësimin e jetës së njeriut.

OJQ-të përbëjnë një komponent thelbësor të procesit të pjesëmarrjes në një shoqëri të hapur e demokratike, duke qenë se mobilizojnë individë në numër shumë të madh. Fakti se shumë prej tyre janë po ashtu edhe *zgjedhës* vë në dukje lidhjen e tyre plotësuese me demokracinë përfaqësive.

OJQ-të mund ta çojnë më përpara procesin vendimmarrës falë shkallës së tyre të gjerë të njohurive dhe aftësisë për ekspertizë të pavarur. Një gjë e tillë ka bërë që të gjitha hallkat qeverisëse – në rrafsh lokal, rajonal e kombëtar –, si dhe të gjitha institucionet ndërkombëtare të mbështeten mbi përvojën dhe kompetencën e OJQ-ve në përpunimin dhe realizimin e politikave të caktuara. OJQ-të gëzojnë besimin e pakrahasueshëm të pjesëmarrësve të tyre dhe të mbarë shoqërisë për të shprehur tërë shqetësimet e tyre, për të përfaqësuar interesat që ata kanë dhe për t’i mobilizuar në mjaft drejtime, që të mund të sjellin kështu një kontribut thelbësor në përpunimin e politikave të caktuara.

Ky tekst vë në dukje kontributin e *shoqërisë civile të organizuar* gjatë procesit demokratik; nuk ka të bëjë thjesht me çështjen që lidhet ngushtë e të, atë të pjesëmarrjes qytetare, domethënë të asaj *individuale*. Krijimi i shoqatave dhe i organizatave në rrafshin e bashkësisë qytetare konsiderohet këtu si një akt organizimi shoqëror autonom, jo i përqendruar thjesht dhe vetëm mbi veprimin individual. Grupet e organizuara janë kështu të ngritura për të bërë të njohura nevojat e pjesëmarrësve të tyre dhe për të çuar përpara interesat e shoqërisë në kuptimin e gjerë të fjalës; shërbejnë pra si një rrymë e fuqishme pjesëmarrjeje dhe si një faktor shumëfishues i zotimeve që marrin përsipër vetë qytetarët.

III.2 Parimet themelore të pjesëmarrjes civile

Për të nxitur një marrëdhënie konstruktive, OJQ-të dhe pushtetet publike në rrafsh të ndryshme duhet ta mbështesin veprimin e tyre mbi këto parime të përbashkëta:

Pjesëmarrja

OJQ-të mbledhin dhe përcjellin mendimet e anëtarëve të tyre, të përdorueseve të shërbimeve publike si dhe të qytetarëve të interesuar për çështje të ndryshme. Një ndihmesë e tillë i jep një vlerë thelbësore procesit vendimmarrës politik, duke fuqizuar cilësinë e nismës politike, kuptimin dhe zbatueshmërinë e saj në shtrirje kohore afatgjatë. Një nga kushtet paraprake për zbatimin e këtij parimi është pra që proceset pjesëmarrëse të jenë të hapura e të afërueshme, si dhe të mbështeten mbi parametra të përcaktuar pjesëmarrjeje, mbi bazën e një marrëveshjeje të përbashkët.

Besueshmëria

Një shoqëri e hapur dhe demokratike bazohet në ndërveprimin e lirë dhe të ndershëm të aktorëve të saj dhe të sektorëve që e përbëjnë. Edhe pse OJQ-të dhe pushtetet publike lypset të luajnë role të ndryshme, objektivi i përbashkët për përmirësimin e jetës së njerëzve mund të arrihet në mënyrë të kënaqshme vetëm po qe se mbështetet mbi parimin e besueshmërisë, gjë që do të thotë transparencë, respekt dhe besim të ndërsjellë.

Llogaridhënia dhe transparenca

Për të vepruar në interes të publikut kërkohet hapje, përgjegjësi, qartësi dhe detyrim për të dhënë llogari si nga ana e OJQ-ve, ashtu dhe nga pushtetet publike, ndërkohë që transparenca shoqëron çdo fazë të veprimtarisë.

Pavarësia

Duhet që OJQ-të të njihen si instanca të lira e të pavarura për sa i përket qëllimeve që kanë, vendimeve që marrin dhe veprimtarive që zhvillojnë. Ato kanë të drejtë të veprojnë në mënyrë krejt të pavarur, si dhe të mbajnë qëndrime të ndryshme nga ato të autoriteteve me të cilat mundet nga ana tjetër të bashkëpunojnë.

III. 3 Kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen civile

Kushtet e nevojshme për jetën shoqërizuese janë më se të njohura. Në bazë të Konventës evropiane për ruajtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive themelore (KEDNJ), ato kërkojnë lirinë e shprehjes (neni 10) dhe lirinë e tubimit dhe të organizimit (neni 11).

Për të garantuar përfshirjen – pa dallim – të ndihmesave thelbësore të OJQ-ve në procesin e vendimmarrjes politike, lypset një mjedis i favorshëm, konkretisht shteti i së drejtës, mbështetja në parimet themelore demokratike, vullneti politik, një legjislacion i përshtatshëm, procedura të qarta e të sakta, mbështetje dhe burime afatgjata për një shoqëri civile të qëndrueshme në kohë, si dhe hapësira të ndërsjella dialogimi e bashkëpunimi. Këto kushte bëjnë të mundur vendosjen midis OJQ-ve dhe pushteteve publike të një marrëdhënieje konstruktive mes tyre, bazuar mbi besimin e ndërsjellë dhe kuptimin e përbashkët për një *demokraci me pjesëmarrje aktive*.

IV. Mënyrat e pjesëmarrjes

Për të arritur qëllimin kryesor të Kodit të praktikave të drejta lidhur me pjesëmarrjen civile, si dhe për të garantuar dobishmërinë dhe zbatueshmërinë e tij konkrete nga ana e OJQ-ve të përfshira në procesin e vendimmarrjes politike, kjo njësi e Kodit tregon, në linja të përgjithshme, se në cilat forma mund të shfaqet pjesëmarrja e shoqërisë civile.


Procesi paraqet dy përmasa të lidhura ngushtë. Nënndarja IV.1 paraqet në radhë të parë nivelet e pjesëmarrjes me shkallëzim intensiteti në rritje, nga vënia e thjeshtë në dispozicion e të dhënave gjer te procesi i konsultimit, dialogu dhe më në fund te partneriteti midis OJQ-ve dhe pushteteve publike. Nënndarja IV.2 paraqet më pas fazat e procesit politik të vendimmarrjes, domethënë gjashtë etapat që ndjekin pushtetet publike, nga përcaktimi i programit gjer te zbatimi i tij, duke kaluar nëpërmjet fazave të monitorimit dhe të riformulimit.

Një nënndarje më vete (IV.3) propozon mjetet që vihen në zbatim gjatë etapave të ndryshme, duke i dhënë një mbështetje transversale procesit të pjesëmarrjes.

Kombinimi i këtyre elementëve krijon një model pjesëmarrjeje civile (V), i cili lejon të vizualizohet karakteri i ndërvarur i procesit.

IV. 1 Nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes

Përfshirja e OJQ-ve në etapat e ndryshme të procesit politik vendimmarrës është në funksion të vetë intensitetit të pjesëmarrjes. Dallohen katër nivele pjesëmarrjeje, konkretisht në rend progresiv: informimi, konsultimi, dialogu dhe partneriteti. Por ato mund të gjejnë zbatim edhe në rend të ndryshëm gjatë gjithë etapave të procesit të vendimmarrjes, veçse jo rrallë herë, shfaqen veçanërisht të përshtatshme për disa nga nivelet e procesit.



1. Informimi

Përfshirja në procesin e informimit përbën themelin e krejt etapave të mëtejshme të veprimtarisë së OJQ-ve në drejtim të vendimmarrjes politike. Kemi të bëjmë këtu me një shkallë pjesëmarrjeje relativisht të dobët, që zakonisht qëndron në dhënien e njëanshme të informacionit nga ana e pushteteve publike, pa kërkuar apo pa pritur ndërveprim me OJQ-të, dhe pa u përfshirë këto në shkallën e duhur në këtë proces.

Informimi është i dobishëm në krejt etapat e procesit të vendimmarrjes.

2. Konsultimi

Është një formë nisme, gjatë së cilës pushtetet publike u kërkojnë OJQ-ve mendimin e tyre lidhur me një temë të caktuar apo për përpunimin e një politike të veçantë. Konsultimi qëndron zakonisht në informimin që autoritetet u bëjnë OJQ-ve rreth zhvillimeve politike aktuale dhe në vjeljen e komenteve, mendimeve dhe reagimeve të tyre. Nisma dhe temat e përcaktuara në këtë drejtim nuk vijnë nga OJQ-të, por nga pushtetet publike.

Konsultimi përfshin krejt etapat e procesit vendimmarrës, e në mënyrë të veçantë hartimin, monitorimin dhe riformulimin.

3. Dialogu

Nisma për dialog mund të merret si nga njëra palë ashtu dhe nga tjetra; dialogu mund të jetë i karakterit të **përgjithshëm**, apo i karakterit **bashkëpunues**.

Dialogu i përgjithshëm është një proces komunikimi i dyanshëm, mbështetur në interesa të ndërsjella dhe në objektiva që shfaqen të përbashkët për të siguruar kështu një këmbim të rregullt pikëpamjesh. Ky dialog shkon nga seancat dëgjimore publike të hapura për të gjithë, gjer te mbledhjet e specializuara midis OJQ-ve dhe pushteteve publike. Diskutimi ruan një karakter shumë të përgjithshëm dhe nuk është posaçërisht i lidhur me ndonjë proces të veçantë përpunimi të një politike të caktuar.

Dialogu bashkëpunues mbështetet mbi interesin e ndërsjellë për përpunimin e një politike të veçantë. Zakonisht çon drejt një rekomandimi, strategjie apo legjislacioni të përbashkët. Është më dinamik se dialogu i përgjithshëm, duke qenë se zhvillohet në mbledhje të përbashkëta, në mjaft raste të shpeshta e të rregullta, me synimin për të përpunuar së bashku strategji të mëdha politike që shpesh çojnë në rezultate të pranueshme me marrëveshje të përbashkët.

Dialogu në këtë rast është shumë i vlerësuar në tërë fazat e ciklit përpunues të një politike, por ai merr rëndësi përcaktuese për krijimin e një programi, hartimin dhe riformulimin e tij.

4. Partneriteti


Partneriteti nënkupton përgjegjësi të ndara për gjithsecilin në çdo etapë të procesit të vendimmarrjes politike gjatë hartimit të programit, përpunimit e vendimit, gjer te zbatimi i vendimit politik. Ai përfaqëson formën më të lartë të pjesëmarrjes.

Në këtë stad, OJQ-të dhe pushtetet publike mblidhen për të bashkëpunuar ngushtë, duke pasur parasysh që kjo gjendje partneriteti të mos u bëhet OJQ-ve pengesë për ruajtjen e pavarësisë së tyre, të së drejtës që gëzojnë për të shprehur mendimet që kanë dhe për të vepruar mbi bazën e tyre. Partneriteti mund të përfshijë edhe forma të tilla veprimtarie si delegimi i një detyre të caktuar tek një OJQ, për shembull duke u dhënë këtyre të drejtën për një shërbim të caktuar, apo për mbledhje të forumeve pjesëmarrëse dhe krijimin e instancave bashkë-vendimmarrëse, përfshirë edhe shpërndarjen e burimeve.

Partneriteti mund të ndërhyjë në krejt fazat e procesit vendimmarrës; është veçanërisht i nevojshëm gjatë fazave të përcaktimit e të zbatimit të një programi.

IV. 2 Etapat e procesit politik vendimmarrës

Cikli i paraqitur në diagramin e mposhtëm përcakton gjashtë etapat e ndryshme të procesit të vendimmarrjes politike: përcaktimi i programit, përpunimi i një politike, marrja e vendimit, zbatimi i politikës, monitorimi dhe riformulimi i politikës. Çdo etapë paraqet mundësi ndërveprimi, për OJQ-të dhe pushtetet publike



1. Përcaktimi i programit

Programi politik arrihet në marrëveshje të përbashkët midis parlamentit dhe qeverisë, por ai mund të përpunohet edhe nga OJQ-të apo grupet e OJQ-ve duke organizuar fushata dhe grupe përkrahjeje rreth çështjeve, nevojave e shqetësimeve të ndryshme. Nismat e reja politike shpesh janë rrjedhojë e ndikimit të fushatave që organizojnë OJQ-të. Gjatë kësaj faze, ato synojnë të ndikojnë tek vendimmarrësit në emër të një interesi kolektiv, dhe veprimi i tyre plotëson më së miri debatin politik.

Ndihmesa e OJQ-ve:

- **Aktivizimi militant:** të ngrihen çështje, të parashtrohen probleme dhe nevoja për grup-përdorues të veçantë të shërbimeve publike, të merret në mbrojtje një çështje e posaçme apo një interes publik i përgjithshëm, ende i pambuluar nga legjislacioni apo aktet juridike, nga mjetet apo masat politike;
- **Informimi dhe ndërgjegjësimi:** të njihen pushtetet publike me pikëpamjet e OJQ-ve, të angazhohen dhe përfaqësohen anëtarët, përdoruesit dhe grupet kryesore të qytetarëve si dhe të merret përsipër roli i ndërmjetësit me qëllim që t'u shkohet sa më pranë qytetarëve; të dëgjohen, të reagoher, si dhe të informohen;
- **Shqyrtimi dhe këshillimi:** specialistët e një çështje konkrete luajnë rol themelor në përcaktimin e një programi politik. Analizat dhe hulumtimet e tyre lejojnë të vlerësohen nevojat – e sotme dhe të nesërme – të shoqërisë dhe çelin perspektiva të një interesi parësor;
- **Ripërpunimi:** kërkimi i zgjidhjeve dhe trajtesave të reja; paraqitja e mënyrës si të përfshihen këto zgjidhje në programin politik;
- **Mënyra e të shërbyerit:** duke u shfaqur OJQ-të si aktorët kryesorë në përpunimin e politikave dhe në krijimin e shërbimeve publike alternative apo të shërbimeve të reja për një grup të veçantë përdoruesish në rast mungese të këtyre shërbimeve;

Përgjegjësitë e pushteteve publike:

- **Dhënia e informacionit:** Të përgatiten informacione të sakta, të reja, në kohë të përshtatshme dhe në mënyrë të pranueshme nga të gjitha palët e interesuara;
- **Procedurat:** Të përcaktohet dhe hartohet një proces vendimmarrës transparent, si dhe të sigurohet përfshirje në të. Të propozohen procedura pjesëmarrjeje të qarta, publike e të hapura;
- **Dhënia e mjeteve:** Të mundësohet pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile duke dhënë për shembull kontribut financiar, ndihmë në natyrë apo duke vënë në dispozicion shërbime të caktuara administrative;
- **Riaktivizimi:** Të sigurohet një pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve të autoritetit përkatës publik; të dëgjohen, të reagoher dhe të parashtrohen vërejtje;

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme:

- **Informacioni:**
 - **Përfshirje e hapur dhe publike** në informacione të përshtatshme, të sakta, aktuale rreth procesit politik përkatës, dokumentacionit dhe vendimmarrësve politikë, për shembull paraqitja e të dhënave në rrjete interneti;
 - **Hulumtim** për të kuptuar një problem shqetësues dhe për të përpunuar zgjidhje të mundshme;
 - **Fushata dhe aksione** të OJQ-ve, me synim ndërgjegjësimi: për shembull proklamata për mbajtje qëndrimi të caktuar, afishe e broshura, rrjete ueb, komunikata shtypi dhe manifestime publike;
 - **Rrjet ueb** i hapur për të gjithë, ku të shfaqet dokumentacioni kryesor, si dhe lajmërimet për manifestime publike;

- **Konsultimi:**
 - **Peticion**, nëpërmjet mjeteve interneti, si për shembull peticioni elektronik apo forumi ueb;
 - **Konsultim**, në internet apo nëpërmjet teknikash të tjera, për të grumbulluar të dhëna rreth interesimeve dhe sugjerimeve të palëve përkatëse.

- **Dialogu:**
 - **Seanca dëgjimi dhe forume** të hapura publike me palët e interesuara për të përcaktuar e kuptuar fushat e ndjeshmërisë dhe të interesit të grupeve të ndryshme;
 - **Forume dhe kuvende të parashikuara për qytetarët**, me qëllim që të diskutohet si me qytetarët, ashtu dhe me OJQ-të;
 - **Bashkëpunim qeveritar**, për t'i bërë të mundur shoqërisë civile të njihet nga afër me informacionin e nevojshëm rreth nismave politike në zhvillim e sipër;

- **Partneriteti:**
 - **Grup pune apo komitet** i krijuar si një grup kompetent i përhershëm apo ad hoc për këshillim apo parapëlqim të politikave të caktuara.

2. Përpunimi

Pushtetet publike ndjekin zakonisht procedura të qëndrueshme për sa i përket përpunimit të një politike. OJQ-të ndërhyjnë në mjaft raste për të përcaktuar problemet, për të propozuar zgjidhjet e mundshme si dhe për t'i mbështetur propozimet e tyre me anë intervistash apo studimesh të caktuara. Lehtësimi i mundësive konsultuese duhet të jetë një element kyç gjatë

kësaj faze, ashtu sikurse format e ndryshme të dialogut, për të qëmtuar tërësisht ndihmesat e partnerëve kryesorë veprues.

Ndihmesa e OJQ-ve:

- **Aktivizimi militant:** të garantohet që nevojat dhe interesat e partnerëve të interesuar për projektin politik janë marrë në konsideratë brenda të gjitha normave;
- **Informimi dhe ndërgjegjësimi:** OJQ-të vënë në dijeni anëtarët e tyre, përdoruesit e shërbimeve publike si dhe grupet kryesore të qytetarëve rreth procesit të përpunimit;
- **Shqyrtimi dhe Këshillimi:** Të paraqitet analiza dhe punime kërkimore rreth çështjeve në shqyrtim, apo të parashtrihen çështjet plotësuese që duhen përfshirë në hartimin e një projekt-politike;
- **Ripërpunimi:** Të propozohen zgjidhje nëpërmjet qasjeve të reja, marrjes së masave praktike dhe modeleve konkrete, në dobi të grupeve të veçanta të përdoruesve të shërbimeve publike;
- **Mënyra e të shërbyerit:** Duke dhënë ndihmesën në përpunimin e politikave të caktuara, për të garantuar marrjen parasysh, mbi bazën e normave, të interesave të veçanta të përdoruesve si dhe plotësimin e kushteve të duhura;
- **Mbikëqyrja:** Të ndiqet procesi i përpunimit për t'u siguruar që shqetësimet e partnerit janë marrë parasysh dhe se procesi është gjithëpërfshirës e transparent.

Përgjegjësitë e pushteteve publike:

- **Informimi:** Të paraqiten rregullisht të dhëna të plota rreth proceseve konsultuese në zhvillim e sipër;
- **Procedurat:** Të përpunohen e të miratohen norma minimale konsultuese; të përcaktohen objektiva të qartë e konkrete, rregulla pjesëmarrjeje, afate, kontakte, etj. Të organizohen mbledhje konsultative të hapura, si dhe të ftohen konkretisht të gjithë partnerët e mundshëm;
- **Mjetet:** Të parashikohen afate të mjaftueshme dhe forma konsultuese të përshtatshme për të garantuar pjesëmarrjen në rrafsh të ndryshme të shoqërisë civile;
- **Riaktivizimi:** Të tregohet kujdes për pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të pushteteve publike përkatëse; të dëgjohet zëri i tyre, të reagohet dhe të sigurohet komentim pas përgjigjeve gjatë fazës konsultuese.

Mjetet dhe mekanizmat:

- **Informimi:**
 - **Përfshirje publike dhe falas për të konsultuar dokumentacionin politik,** krijimi në mënyrë të veçantë i një qendre informacioni të vetme dhe të

përbashkët për përpunimin e politikave, qendër e vënë në dispozicion në forma të ndryshme, me qëllim që të prekë tërësinë e publikut të interesuar;

- **Rrjet ueb** i hapur për të gjithë, ku të shfaqet dokumentacioni kryesor, si dhe lajmërimet për manifestime publike;
 - **Fushata dhe grupe lobimi** për t'i dhënë formë projektit politik me dokumente që shprehin qëndrim të caktuar, me rekomandime përmes letrash dhe me deklarime publike;
 - **Përhapje nëpërmjet rrjeteve ueb** të seancave të dëgjimit, të mbledhjeve dhe të debateve që u lejojnë përdoruesve të internetit t'i ndjekin në kohën e duhur;
 - **Realizim i studimeve** për t'i dhënë një mbështetje procesit të përpunimit të politikave.
- **Konsultimi dhe dialogu:**
 - **Seanca dëgjimi dhe pyetje-përgjigjesh** me partnerët për të përcaktuar dhe kuptuar shkallën e ndërjegjësimin dhe të preokupimeve, si dhe për të mbledhur propozime, qoftë në tryeza të rumbullakëta, qoftë nëpërmjet internetit;
 - **Seminare ekspertësh dhe mbledhje**, në të cilat përfshihen specialistë për fillimin e hulumtimeve dhe të studimeve të specifikuara, që mund t'i shërbejnë posaçërisht fazës së përpunimit;
 - **Komitete me shumë partnerë dhe organe konsultative** të përbëra nga përfaqësues të sektorit të OJQ-ve ose duke përfshirë në to edhe përfaqësues të tyre; këto komitete apo organe konsultative mund të jenë të përhershme apo ad hoc.
 - **Partneriteti:**
 - **Bashkë-hartimi:** përfshirje aktive në aspektet hartuese të procesit legjislativ.

3. Vendimi

Marrja e vendimit politik merr forma të ndryshme sipas kontekstit dhe legjislacionit të çdo vendi. Megjithatë, ajo paraqet karakteristika të përbashkëta, sikurse është konkretisht përcaktimi i një direktive qeveritare nëpërmjet miratimit të një ministri apo nëpërmjet kuadrit ligjor (për shembull, miratimi i një ligji me votim parlamentar) apo nëpërmjet një referendumi publik, i cili më pas kërkon një legjislacion zbatues. Projekt-ligjet dhe propozimet duhet të jenë të hapura për kontributin dhe pjesëmarrjen e OJQ-ve. Pushtetet publike duhet të mbajnë parasysh mendimet dhe opinionet e ndryshme që i paraprijnë fazës së marrjes së vendimit. Në këtë etapë, konsultimi është i domosdoshëm për një vendim të bazuar. Por prapë, fuqia vendimmarrëse i takon përfundimisht pushteteve publike, veç po që se vendimi merret nëpërmjet votës publike, referendumi apo nëpërmjet një mekanizmi bashkë-vendimmarrës.

Ndihmesa e OJQ-ve:

- **Aktivizimi militant:** Të ushtrohet ndikim mbi vendimmarrësit përpara një votimi;
- **Informimi dhe ndërgjegjësimi:** të vihen në dijeni anëtarët, përdoruesit dhe grupet kryesore të qytetarëve mbi vendimet politike dhe efektet e tyre të mundshme;
- **Shqyrtimi dhe këshillimi:** të propozohet një analizë e hollësishme për të informuar vendimmarrësit dhe për të ushtruar ndikim tek ta;
- **Mbikëqyrja:** të ndiqet nga afër procesi vendimmarrës, të tregohet kujdes që ai të jetë demokratik, transparent dhe me efekt optimal.

Përgjegjësia e pushteteve publike:

- **Informimi:** të paraqiten të dhëna rreth politikave vendimmarrëse në zhvillim e sipër;
- **Procedurat:** të propozohen e të ndiqen procedura të përshtatshme lidhur me mekanizmat e bashkë-vendimmarrjes në rast nevojë;
- **Mjetet:** të mundësohet e të mbështetet pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile duke afruar OJQ-të në fazën e vendimmarrjes;
- **Riaktivizimi:** Të dëgjohet zëri i shoqërisë civile dhe të merret në konsideratë ndihmesa e saj, si dhe të jepen përgjigjet e duhura për çështjet e ngritura.

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme:

- **Informimi:**
 - Të organizohen fushata dhe grupe lobimi për të ushtruar ndikim mbi vendimmarrësit, për shembull nëpërmjet fletë-palosjeve, rrjeteve ueb, komunikatave të shtypit dhe manifestimeve publike.
- **Konsultimi e dialogu:**
 - Sesione plenare apo mbledhje komisionesh publike me qëllim që të garantohet përfshirja e lirë në debate gjatë marrjes së vendimit.
- **Partneriteti:**
 - Vendim i përbashkët në kuadrin e forumeve, konferencave konsensuale dhe takimeve të tjera pjesëmarrëse;
 - Bashkë-vendimmarrja, për shembull për përcaktimet buxhetore pjesëmarrëse.

4. Zbatimi

Pikërisht, gjatë kësaj faze, mjaft OJQ tregohen më aktivet, për shembull në ngritjen e shërbimeve dhe realizimin e projekteve. Një pjesë e madhe e punës së kryer nga OJQ-të gjatë fazave të mëparshme ka ngulmuar konkretisht se si të ndikojnë sa më mirë në zbatimin e politikës. Kjo fazë është veçanërisht e rëndësishme për të garantuar arritjen e rezultatit të kërkuar. Përfshirja në një informacion të qartë, të saktë dhe transparent rreth pritshmërisë dhe mundësisë së rezultatit të dëshiruar është shumë e rëndësishme gjatë kësaj faze, ashtu sikurse partneritetet aktive.

Ndihmesa e OJQ-ve :

- **Informimi dhe ndërgjegjësimi:** Duke u përqendruar në mënyrë parësore mbi sensibilizimin e publikut, të shpjegohen dobitë apo dobësitë e një politike të caktuar, si dhe pasojat që mund të rrjedhin prej saj;
- **Mënyra e të shërbyerit:** duke u shfaqur OJQ-të në të shumtën e rasteve si të vetmit aktorë për zbatimin e nismave politike; duke mbajtur ato përgjegjësinë kryesore në ngritjen e shërbimeve në fjalë;
- **Funksioni i mbikëqyrjes:** të mbahet parasysh dhe të sigurohet se politika po gjen zbatim sipas parashikimit të bërë dhe e pa shoqëruar nga efekte të dëmshme.

Përgjegjësitë e pushteteve publike:

- **Informimi:** të jepet informacion rreth strategjive të zbatuara dhe rreth procedurave të ndjekura për organizim tenderash, si dhe rreth udhëzimeve të dhëna për realizim të projekteve;
- **Procedurat:** të ndiqen rregullat dhe rregulloret e vendosura për zbatimin e politikave;
- **Dhënia e mjeteve:** të mundësohet pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në fazën e zbatimit, duke dhënë për shembull kredi buxhetore, mbështetje në natyrë apo kompensime administrative;
- **Riaktivizimi:** të tregohet gatishmëri, si dhe të reagohet ndaj nevojave të veçanta që kanë të bëjnë me zbatimin e politikës.

Mjete dhe mekanizma të nevojshme:

- **Informimi:**
 - **Mundësi për të shfrytëzuar lirshëm dhe publikisht** dokumentacionin e sektorit publik që ka lidhje me projektet dhe vendimet për zbatim;
 - **Rrjete ueb** të hapura për të gjithë, me qëllim që të konsultohen dokumentet kyçe dhe të krijohet mundësia për lajmërim në internet lidhur me manifestimet publike;

- **Njoftime me e-mail** për projektet e parashikuara dhe për mundësitë e financimit;
 - **Shqyrtim i çështjeve të trajtuara** në rrjetet e internetit dhe kanale të tjera për dhënie informacionesh në formën pyetje-përgjigje, me qëllim që të jepet ndihma e duhur dhe këshilla praktike;
 - **Shpallje tenderash**, për të siguruar hapjen dhe transparencën e procedurës së ofertave në shërbimet publike.
- **Konsultimi:**
 - **Mbledhje, konferenca, forume e seminare** për të njoftuar OJQ-të dhe publikun lidhur me zbatimin e një politike të caktuar, si dhe për të diskutuar me ta rreth kësaj politike.
- **Dialogu:**
 - **Seminare për rritjen e kapaciteteve** lidhur me thellimin e njohurive dhe të kompetencave në fushën e zbatimit të projekt-politikave;
 - **Seminare formimi** për OJQ-të dhe pushtetet publike lidhur me çështje të veçanta në fushën zbatuese, si paraqitja e projekteve dhe kërkesat për financim.
- **Partneriteti:**
 - **Partneritet strategjik** midis OJQ-ve dhe pushteteve publike për zbatim të politikës: mund të shkohet nga një projekt i vogël pilot gjer te përgjegjësia e plotë e zbatimit të projektit.

5. Monitorimi

Në këtë fazë, roli i OJQ-ve është të ndjekë e të vlerësojë rezultatet e politikës së zbatuar. Në këtë drejtim, lypset të krijohet një sistem monitorimi i efektshëm dhe transparent, me qëllim që të garantohet arritja e objektivit të përcaktuar të program/politikës.

Ndihmesa e OJQ-ve:

- **Aktivizimi militant** : të ndiqet nga afër nisma politike dhe të bëhet e ditur nëse kjo nismë ka arritur të jetë e ndjeshme tek përfituesit e synuar, si dhe ka dhënë për shoqërinë rezultatet e parashikuara;
- **Shqyrtimi dhe këshillimi:** të mblidhen të dhëna dhe të bëhen studime rreth rezultatit të arritur nga politika, konkretisht duke vënë në lëvizje “laboratorët” e ideve dhe institutet kërkimore;

- **Mënyra e të shërbyerit:** duke vëzhguar e studiuar ndikimet e programit lidhur me cilësinë, qëndrueshmërinë, efektshmërinë e tij, si dhe duke dhënë shembuj rastesh konkrete;
- **Mbikëqyrja:** merr rol parësor në procesin e monitorimit të rezultateve të politikës, me qëllim që të tregohet kujdes për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Përgjegjësitë e pushteteve publike:

- **Informimi:** Të jepen të dhëna rreth gjendjes aktuale të një politike;
- **Riaktivizimi :** të dëgjohet fjala e OJQ-ve dhe e shoqërisë civile, si dhe të reagohet ndaj çështjeve të veçanta që ato ngrenë.

Mjete dhe mekanizma të nevojshëm:

- **Informimi:**
 - **Mundësi për njohje publike dhe falas të të dhënave** që kanë të bëjnë me zhvillimin e një politike të caktuar;
 - **Mbledhje të dhënash** lidhur me gjendjet dhe statistikat në realizimin e një projekti;
 - **Vlerësim** i një politike të caktuar dhe i ndikimit që ajo ushtron nëpërmjet organizimit të konferencave dhe paraqitjes së raporteve;
 - **Studime** të pavarura për të vjelë njohuritë bazë.
- **Konsultimi:**
 - Mekanizma periodikë për të ndjekur evolucionet, si sondazhet, anketimet me anë interneti, apo pyetësorët.
- **Dialogu:**
 - **Grup pune apo komitet** i përbërë nga OJQ-të (përdoruesit dhe furnizuesit e shërbimeve publike), si dhe i ngarkuar për monitorimin dhe zhvillimin e nismës politike.
- **Partneriteti:**
 - **Grup pune apo komitet** i përbërë nga OJQ-të dhe nga pushtetet publike, të përfshira brenda një partneriteti strategjik për të ndjekur e vlerësuar nismën politike.

6. Reformulimi

Nisur nga nevojat në zhvillim e sipër të shoqërisë, njohuritë e përfituara nëpërmjet vlerësimit që i bëhet zbatimit të një politike të caktuar, kërkojnë në mjaft raste reformulimin e vetë kësaj politike. Në këtë rast, kërkohet njohje nga afër e informacioneve si dhe mundësi dialoguese për të konkretizuar nevojat dhe nismat. Reformulimi lejon fillimin e një cikli të ri vendimmarrës.

Ndihmesa e OJQ-ve:

- **Aktivizimi militant:** të bëhet presion për një rishikim të politikës, duke nxjerrë në pah kufizimet dhe efektet anësore të një politike në zhvillim e sipër, për t'iu përgjigjur nevojave të përdoruesve të shërbimeve publike apo qytetarëve;
- **Shqyrtimi dhe këshillimi:** të bëhen kërkime e analiza për të nxjerrë dobësitë e një nisme politike në zbatim, si dhe të përligjet nevoja për reformulim të kësaj politike;
- **Ripërpunimi:** përpunimi i trajtesave të reja lidhur me një çështje të caktuar; në këtë fazë mund të shfaqet një element kyç i një politike të re;
- **Mënyra e të shërbyerit:** duke identifikuar pengesat që mund të hasen dhe duke mbledhur prova për të paraqitur nevojat në rritje, të cilat kërkojnë një reformulim të politikës së ndjekur.

Përgjegjësitë e pushteteve publike:

- **Informimi:** të jepen të dhëna mbi mundësinë për një rishqyrtim të politikës, duke paraqitur këndvështrimin e ndryshimeve të kërkuara në këtë drejtim;
- **Procedurat:** të parashikohen procese pjesëmarrjeje të qarta e të sakta, të hapura e gjithëpërfshirëse;
- **Mjetet:** të mbështetet dhe nxitet pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile;
- **Riaktivizimi:** të dëgjohet fjala e OJQ-ve dhe të mbahet parasysh për të vepruar.

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme:

- **Informimi:**
 - **Përfshirje publike dhe e lirë në informacion:** vlerësime, konkluzione studimore, të dhëna të tjera lidhur me politikën në fuqi.
- **Konsultimi:**
 - **Konferencë apo mbledhje,** për të paraqitur etapat në vazhdim parashikuar nga instanca publike;

- **Konsultimi nëpërmjet internetit**, për të pasur parasysh pikëpamjen e shoqërisë civile lidhur me mënyrën për të vijuar një politikë/një projekt të caktuar.
- **Dialogu:**
 - **Seminare dhe forume për rrahje mendimesh**, nëpërmjet partnerëve të interesuar për përpunimin e orientimeve të reja në fushën politike, për shembull mbledhje *World cafe*, *Open space*, dhe metoda të tjera pune në grup (*brainstroming*).
- **Partneriteti:**
 - **Grup pune apo komitet** në gjirin e të cilit OJQ-të formojnë një grup ekspertësh së bashku me partnerë të tjerë dhe me pushtetet publike, me qëllim që të rekomandohet një politikë e rishikuar.

IV. 3 Mjete dhe mekanizma të ndërthurur për një pjesëmarrje civile

Një numër mjetesh a mekanizmash u volën në gjithë Evropën gjatë konsultimit për përpunimin e këtij kodi; ato i japin një mbështetje të gjithanshme pjesëmarrjes shoqërore gjatë procesit vendimmarrës:

1. Pjesëmarrje elektronike

Mjetet elektronike krijojnë mundësi të mëdha për të përmirësuar praktikën dhe pjesëmarrjen demokratike të një shoqërie civile të organizuar. Ato mund të ndihmojnë në masë të madhe për transparencën, me kusht që institucionet të reagojnë e të japin llogari, si dhe të bëjnë vlerësimin e shkallës së pjesëmarrjes të qytetarëve dhe të nivelit të autonomizimit të tyre, pa lënë mënjanë gjithëpërfshirjen dhe të drejtën e pjesëmarrjes tërësore si kriteret e procesit demokratik. Me qëllim që të përfitohet plotësisht nga potenciali i tyre, mjetet elektronike duhet të përfshihen në procesin politik nga gjithë pjesëmarrësit, si dhe nga autoritetet në krejt rrafshet e shoqërisë civile të organizuar.

2. Rritja e mundësive për pjesëmarrje

Është e domosdoshme të rriten aftësitë dhe kompetencat e OJQ-ve lokale, rajonale e kombëtare, me qëllim që t'i bashkëngjiten aktivisht përpilimit të një politike të caktuar, përpunimit të një projekti, si dhe forcimit të sektorëve të shërbimit publik. Në drejtim të rritjes së kompetencave mund të shërbejnë po ashtu edhe seminarët, për një kuptim më të mirë të rolit të ndërsjellë të OJQ-ve e të pushteteve publike në këtë proces përfshirjeje, si dhe programet shkëmbyese për të lehtësuar kuptimin e ndërsjellë të fushës vepruese të palëve pjesëmarrëse.

3. Strukturat për bashkëpunim midis OJQ-ve dhe pushteteve publike

Me qëllim që të lehtësohen marrëdhëniet midis pushteteve publike dhe OJQ-ve, një numër vendesh kanë ngritur instanca koordinuese. Këto përfshijnë, ndër të tjera, instanca qeveritare

(një person kontakti për shoqërinë civile në çdo ministri, apo një instancë qendrore koordinuese, për shembull një ndërlidhës i vetëm), struktura të përbashkëta (komitete shumë-partneriale, grupe pune, këshilla ekspertësh dhe instanca të tjera konsultative, të përhershme apo ad hoc), apo më në fund grupime/bashkime OJQ-sh që vënë në përdorim burime të përbashkëta duke shfaqur e përpunuar qëndrime të njëjlojta.

4. Dokumente-kuadër për një bashkëpunim midis OJQ-ve dhe pushteteve publike

Në shumë vende evropiane, janë përpunuar marrëveshje-kuadër për të përcaktuar në vija të përgjithshme nismat, rolet dhe përgjegjësitë, si dhe procedurat bashkëpunuese. Këto dokumente pasqyrojnë më së miri bazat kryesore të kësaj lloj lidhjeje dhe lehtësojnë në këtë mënyrë dialogun e vazhdueshëm dhe kuptimin reciprok midis OJQ-ve dhe pushteteve publike. Është fjala konkretisht për marrëveshje dypalëshe me një parlament apo një qeveri të caktuar, për dokumente strategjike dhe programe zyrtare bashkëpunimi, të miratuara nga pushtetet publike.

V. Modeli i pjesëmarrjes civile

Me qëllim që të pasqyrohet e të qartësohet ndërveprimi, modeli i mposhtëm lejon të shfaqen në mënyrë pamore fazat e procesit të vendimmarrjes politike, sipas niveleve të ndryshme të pjesëmarrjes. Ky model mbështetet në praktikën e drejta të ndjekura deri më sot dhe në shembujt pozitivë nxjerrë nga shoqëria civile në tërësinë e vendeve të Evropës; ai synon të nxisë dhe të forcojë ndërveprimin midis OJQ-ve dhe pushteteve publike.

Çdo fazë të procesit vendimmarrës (nga e majta në të djathtë) i korrespondojnë nivele të ndryshme pjesëmarrjeje të OJQ-ve (nga poshtë – lart). Etapat e procesit vendimmarrës janë të zbatueshme për kontekste të ndryshme aktuale në Evropë, në rrafsh lokal, rajonal a kombëtar. Nivelet e pjesëmarrjes nga njëra fazë në tjetrën gjatë procesit vendimmarrës ndryshojnë, herë më dobët, herë më fuqishëm dhe mjetet e propozuara duhet të shërbejnë për zbatuar mënyrat e ndryshme të nxitjes së pjesëmarrjes. Ky model mund të përdoret në forma të ndryshme: mund të shërbejë, për shembull, për të krijuar hartën e niveleve përfshirëse të shoqërisë civile gjatë një procesi politik të dhënë apo për të vlerësuar pjesëmarrjen e një OJQ-je në këtë apo atë çast të procesit. Mund të shërbejë po ashtu si burim konkret për një OJQ, me qëllim që të programojë veprimtaritë e saj në fushën politike. Modeli nuk pretendon të jetë i vetëm, i karakterit shterues, dhe mund të përshtatet edhe për përdorime në fusha të tjera.

Modeli ilustron elementët e ndërvarur të pjesëmarrjes gjatë procesit të vendimmarrjes. Ky shembull tregon se si mjetet e nevojshme, që përmenden në këtë Kod, lejojnë konkretisht të arrihet niveli i synuar i pjesëmarrjes gjatë etapave të ndryshme të procesit vendimmarrës.

Partneritet	Grup pune apo komitet	Bashkë-përpunim	Vendim i përbashkët Bashkë-vendim	Partneritete strategjike	Grupe pune apo komitete	Grupe pune apo komitete
Dialog	Seanca dëgjimore dhe forume publike Forume qytetarësh dhe këshilla të ardhshme Pika kontaktuese kryesore qeveritare	Seanca dëgjimore dhe panele pyetje-përgjigje Seminare ekspertësh Komitete shumëpalëshe dhe instanca konsultative	Sesione plenare apo mbledhje të komiteteve publike	Seminare për forcimin e kapaciteteve Seminare formuese	Grupe pune apo komitete	Seminare dhe forume debatuese dhe votuese
Konsultim	Peticione Konsultim nëpërmjet internetit apo teknikave të tjera	Seanca dëgjimore dhe panele pyetje-përgjigje Seminare ekspertësh Komitete shumëpalëshe dhe instanca konsultative	Sesione plenare apo mbledhje të komiteteve publike	Manifestime, konferenca, forume, seminare	Mekanizma rikthyes	Konferenca apo mbledhje Konsultime në internet
Informim	Përfshirje e lirë dhe publike në informacion Hulumtim Fushata dhe lobime Rrjet ueb për dokumente kyçe	Përfshirje publike dhe falas në konsultimin e dokumenteve orientuese Rrjet ueb për dokumente kyçe Fushata dhe lobime Pasqyrime të reja në rrjetin ueb, Ndihmesë shkencore	Bërje fushatash dhe presion	Përfshirje publike në informacion Rrjet ueb për përfshirje në informacion Tërheqje vëmendjeje me e-mail Rishqyrtime të çështjeve Procedura publike tenderash	Përfshirje publike në informacion Mbledhje provash Vlerësime Punë kërkimore	Përfshirje publike në informacion
Nivelet e pjesëmarrjes	Krijimi i programit	Përpunimi	Vendimi	Zbatimi	Monitorimi	Riformulimi
Etapat e procesit vendimmarrës politik						